



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.372/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Toifor shpk me seli ne Prishtinë, të cilin e përfaqëson Ismail Selimi avokat në Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Shërbimeve me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Arbër Istrefi avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.612/23 i datës 22.06.2023, me datën 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Toifor shpk me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.612/23 i datës 22.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.612/23 datës 22.06.2023, ka Pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Shërbimeve me seli në Prishtinë, dhe ka Shfuqizuar Urdhri përmbartimor P.nr.203/20 datës 25.09.2020 i lejuar nga përmbartuesi privat Rrezarta Metaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën, ta shfuqizoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.612/23 i datës 22.06.2023, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P,nr.203/20 datës 25.09.2020.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Toifor shpk me seli ne Prishtinë me datën 25.09.2020 ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorit Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Shërbimeve me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.59/2020 dt.17.06.2020, me të cilin ka kërkuar pagesën e borxhit në shumë prej 11,970.00€, me kamatë ligjore 8%, nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës e deri ne pagesën e borxhit kryesor.

Përmbareuesi privat me Urdhri përmbareimor P.nr.203/20 datës 25.09.2020 ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm përkatësisht faturës nr.59/20 dt.17.06.2020.

Ndaj këtij urdhri përmbareimor debitori kundërshton urdhrin për faktin se i njëjti është në kundërshtim me provat e bashkangjitura ngase fatura në fjalë nuk përbën dokument përmbareues dhe nuk paraqet titull ekzekutiv, kreditori nuk ka bashkangjitur ndonjë kontratë për kryerjen e këtyre shërbimeve, i propozon gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përmbareimor, si dhe të detyrohet kreditori ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbareimore.

Në përgjigjen në prapësim kreditori thekson se borxhi sipas faturës është bërë i kërkueshëm pas kalimit të afatit prej 8 ditësh dhe se debitori vet ka kërkuar nga kreditori vendosjen, pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve sipas kontratës, i propozon gjykatës që të refuzohet në tërsi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës përmbareimore dhe shpenzimet e avokatit.

Gjykata e shkallës së parë, në rivendosje, duke vepruar sipas aktvendimit KDHSII.270/22 dt.24.03.2023 të Dhomës së shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, pasi ka shqyrtuar pretendimet e debitorit, kundërshtimit të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në lëndë, ka marr aktvendimin kontestues KPPP.nr.612/23 datës 22.06.2023 me të cilin ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe urdhri përmbareimor duhet të anulohet dhe procedura përmbareimore të shfuqizohet. Gjykata gjeti se fatura në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbareim nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar të debitori, pasi që e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit, nuk mban vulën e pranimit –protokolimit si dhe nuk është e nënshkruar nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* ne rastin konkret fatura madje është kopje dhe jo origjinal apo kopje e vërtetuar siç kërkojnë dispozita ligjore.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Dhomat e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura si dokument në sajë të së cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk është e vëltur nga debitori e as e nënshkruar nga ana e tij, andaj kjo gjykatë vlerëson se me te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozimi për përmbarim i kreditorit mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, dhe në këtë rast urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet.

Dhomat e shkallës së dytë nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore të kreditorit i cili në ankesë thekson se me datën 17.06.2020 ka parashtruar kërkesë te debitori për pagesën e borxhit e cila kërkesë është protokolluar me të njëjtën datë, me numër pranimit 07-422/01-94733/20, së bashku me faturën. Kjo gjykatë vlerëson se dorëzimi i kërkesës dhe faturës nga kreditori nuk nënkupton se debitori ka pranuar borxhin sipas faturës 59/2020 datës 17.06.2020, dhe se në shkresat e lëndës nuk provohet se debitori si institucion, ka pranuar faturën e lartcekur,

Përndryshe në procedurën përmbaremore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.372/24 me datë 15.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha